



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 37, paragrafi 3.1 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 10 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 për pranimin e personelit të përkohshëm në KQZ, si dhe Vendimit nr.01-1118/2024, të datës 23.07.2024, të Kqz, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

KONKURS

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialist i administrimit të përgjithshëm
Titulli i pozitës së punës	Asistent për anëtar të KQZ-së
Klasa e pozitës	Profesional 3
Koeficienti/ paga	4.2 / 462 €
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Kontratë kornizë deri në 3 vite me angazhim sipas nevojave të KQZ
Data e njoftimit	16/08/2024
Afati për aplikim	17/08/2024 – 21/08/2024
Institucioni	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Departamenti Divizioni	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i referencës	
Kodi	

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Procedon çështjet administrative për funksionim më efikas;
- Pranon, mirëmban dhe azhurnon dosjet, sistemon raportet, korrespondencën dhe materialet tjera relevante;
- Organizon takimet dhe azhurnon kalendarin e takimeve të mbikëqyrësit;
- Pranon thirrjet nëpërmjet telefonit dhe postës elektronike, mban shënime dhe njofton mbikëqyrësin për kohën, datën dhe temën e takimit;
- Ndhmon në përgatitjen e materialeve dhe dokumenteve zyrtare;
- Kryen detyra të tjera teknike-administrative që kërkohen nga mbikëqyrësi;

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë, sipas neni 9 të LZP

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimimin, dhe/ apo aftësi të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar	Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të.
Lloji i arsimimit	
Kualifikime të posaçme formale	Aplikimi është i hapur për pjesëtarët e komuniteteve të nën përfaqësuar.
Përvoja e punës e kërkuar	Nuk kërkohet.
Kërkesat specifike	Patentë Shofer të Kategorisë-B.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Integritet të lartë personal dhe profesional;

- Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e diplomës së kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurën e nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;

6. Dëshmitë që kërkohen në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata, ose e shkarkuar nga platforma elektronike e - Kosova, përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/ e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.

7. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu me datën 10/09/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/ aplikantëve

- Intervista – maksimumi 100 pikë.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mailit dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portali për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhënat shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bënë verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinale apo të njësuara me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të parapara, nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.